



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 01/22

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 10. 01. 2022

VUŠITRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 44.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 46.2 të Statutit të Komunës, dhe nenit 9.1 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, si dhe sipas kërkesës së Kryetarit të komunës, Kryesuesja e kuvendit të komunës:

Iu fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e cila do të mbahet më datë **14 janar 2022 (e premte)** me fillim në ora **10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	znj. Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për thirrje të mbledhjes së jashtëzakonshme të kuvendit të komunës



E nderuar znj. Kryesuese e kuvendit,

Në pajtim me nenin 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenin 46.2 të Statutit të Komunës, kërkoj që të thirret mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës e cila dot mbahet me datën 14 janar 2022, me fillim në ora 10:00 në sallën e kuvendit.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R e n d D i t e

1. Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Bashkëngjitur me kërkesë keni materialin e rendit të ditës.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI



Për,
Propozues,
Çështja për shqyrtim,

Kuvendin e Komunës
Kryetari i Komunës
Propozim-vendim

B. P. AMUZI

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 3, 4, 5 dhe 6 paragr. 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 41.2, "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, merr këtë:

V E N D I M PËR THEMELIM TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa nga radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Melihate Basholli Latifi, PDK – Kryesuese e KPF
 - 1.2 _____
 - 1.3 _____
 - 1.4 _____
 - 1.5 _____
 - 1.6 _____
 - 1.7 _____
 - 1.8 _____
 - 1.9 _____
2. Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është i njëjte me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.
4. Anëtarët e KPF-së, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.
5. Ky vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e Kuvendit - KPF-së

A r s y e t i m

Me konstituimin e organeve të reja pas zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar në këtë rast kuvendin e komunës, është obligim ligjor që të themelohen edhe trupat punuese të kuvendit të cilat do të i ndihmojnë në ushtrimin e funksioneve ligjore më qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave ndaj qytetarëve të komunës së Vushtrrisë.

Në pajtim me mandatin ligjorë që e kam si Kryetar i komunës, ju dërgoj këtë propozim vendim i cili është i bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë si dhe Statutin e komunës.

Bazuar në numrin e anëtarëve të Kuvendit të komunës së Vushtrrisë, Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të ketë jo më shumë se nëntë (9) anëtar.

Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës. Entiteti politik me numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend do të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon më entitetin e dytë që ka numrin më të madh të anëtarëve të kuvendit e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet në komitet.

Komiteti për politikë dhe financa duhet të reflektoj barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi. (Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 6, paragr. 8).

Anëtarët e komitetit për politikë dhe financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve të tjera.

Bazuar në të cekurat më sipër, i propozoj kuvendit të komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv, duke respektuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara me dispozitat ligjore të përmendura në arsyetimin e këtij vendimi.

Me respekt!

- 2.4. trajtim preferencial, rekrutimin, punësimin dhe ngritjen në detyrë, dhe masa të tjera në secilën fushë ku ka pabarazi.
3. Kandidati i gjinisë së nënpërfaqësuar duhet t'i ketë kualifikimet e njëjta me ato të kundër kandidatit të tij për sa i përket plotësimit të kushteve.
4. Aplikacioni i secilit kandidat i nënshtrohet një vlerësimi objektiv i cili duhet të merr parasysh të gjitha kriteret që janë karakteristike për secilin kandidat individual;
5. Përparësia e dhënë kandidatit të gjinisë së nënpërfaqësuar nuk mund të jetë automatike dhe e pakushtëzuar por, mund të shpërfilllet nëse arsyet specifike për një kandidat individual mund të shkojnë në favor të tij.
6. Nuk përbëjnë diskriminim gjinor rastet kur institucionet publike marrin masa të veçanta, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përshejtimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve. Këto masa duhet të pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar.
7. Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.
8. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.

KAPITULLI II

MEKANIZMAT INSTITUCIONALE PËR BARAZI GJINORE

Neni 7

Agjencia për barazi gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore është Agjenci Ekzekutive (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM-së).

Neni 8

Funksionet dhe përgjegjësitë

1. Agjencia, në fushëveprimin e vet, ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. promovon, mbështetë, koordinon dhe bënë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në pajtim me këtë ligji;

1.2. i propozon Qeverisë ndryshimet/plotësimet e ligjeve dhe akteve nënligjore, si dhe miratimin e masave tjera për zbatimin e këtij ligji, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi;